

## **(BPSAR)**

Autoriteti i Aviacionit Civil në Kosovë, Aeroporti i Prishtinës dhe Misioni i NATO-s në Kosovë (Forca e Kosovës – KFOR-i) do të dëshironin të këshillonin dhe konfirmonin si më poshtë. Në lidhje me themelimin e linjës së veçantë dhe të ndërsjellë ajrore Beograd-Prishtinë për Grupin Lufthansa:

Palët e shprehin qëllimin e tyre për themelimin e Linjës së drejtpërdrejtë dhe të Veçantë Ajrore Beograd-Prishtinë (BPSAR). Njësia e Kontrollit të Trafikut Ajror (ATC) në Aeroportin e Prishtinës është autoritet kompetent për të ofruar shërbime të Kontrollit të Trafikut Ajror brenda sektorit të KFOR-it. KFOR-i është autoritet kompetent për mbikëqyrjen e dispozitave të shërbimeve të Kontrollit të Trafikut Ajror brenda sektorit të KFOR-it dhe përmbushjen e tyre në mënyrë të sigurt. Njësia e Kontrollit të Trafikut Ajror në Aeroportin e Prishtinës do të ofrojë shërbime të Kontrollit të Trafikut Ajror për të gjithë aeroplanët që kontrollohen nga kompania “Eurowings” dhe transportuesve të Grupit Lufthansa brenda hapësirës ajrore të KFOR-it.

Këtu përfshihen fluturimi përmes linjave të drejtpërdrejta ajrore nga Prishtina në Beograd dhe anasjelltas, nisjet dhe aterimet në aeroportet e Prishtinës/Beogradit, në pajtueshmëri me Marrëveshjen për BPSAR-in. Si segment i shërbimeve të Kontrollit të Trafikut Ajror, komunikimi i drejtpërdrejtë do të zhvillohet mes ofruesve të shërbimeve në aeroporte, përfshirë ofruesit e shërbimeve të Kontrollit të Trafikut Ajror në Aeroportin e Beogradit apo të ndonjë kontrolli tjetër të trafikut ajror që kërkohet.

Institucionet në Kosovë, në pajtueshmëri me Marrëveshjen për BPSAR-in, do t’ua ofrojnë të drejtën kompanisë “Eurowings” dhe transportuesve të Grupit Lufthansa për ta zbatuar planin e fluturimit duke e përdorur kodin ICAO të BKPR-së për shërbimet mes Prishtinës dhe Beogradit. Autorizimet përkatëse për hapësirën ajrore do të mbesin efektive, pa ndonjë miratim shtesë. Dhënia e pëlqimit i kërkon regjistrimin dhe lejet e nevojshme të lëshuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil në Kosovë, të cilat nuk do të tërhiqen në rast se kompania “Eurowings” apo transportuesi i Grupit Lufthansa ka mundësi të paraqesë dokumentacion tipik dhe relevant të aeroplanit.

Operimi i tanishëm do të jetë subjekt i fizibilitetit komercial, teknik dhe procedural nga kompania “Eurowings” apo një transportues i Grupit Lufthansa, me përkrahjen e plotë të të gjitha palëve.

Aeroporti i Prishtinës menaxhohet dhe kontrollohet nga operatorët relevantë komercialë. Nëse kërkohet nga kompania “Eurowings” apo një transportues i Grupit Lufthansa, Aeroporti i Prishtinës do të nënshkruajë një marrëveshje të bazuar në Marrëveshjen Standarde për Menaxhimin Tokësor të IATA-së me Divizionin Lufthansa-Euroëings, duke siguruar që kompania “Eurowings” dhe transportuesit e Grupit Lufthansa do të marrin përkrahje të plotë për t’i ofruar shërbimet për pasagjerë

në bazë të BPSAR-it. Këtu përfshihen përkrahja e ndërsjellë për menaxhimin e shërbimeve për pasagjerë, mallra dhe shërbime postare, mbushjen me karburant dhe përkrahjen gjatë lëshimit në tokë dhe ngritjes në qiell, shërbimin e pasagjerëve, mallrave, postës, valixheve dhe hyrjeve/daljeve të udhëtarëve që udhëtojnë përmes linjës BPSAR. Shërbimet duhet ta gëzojnë nivelin e njëjtë të shërbimit si çdo shërbim tjetër nga dhe drejt Prishtinës. Marrëveshjet për Lirinë e Lëvizjes dhe Marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, të arritura gjatë dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës, do të zbatohen për pasagjerët, postën dhe mallrat që transportohen përmes kësaj linje ajrore.

**Autoriteti i Aviacionit Civil në Kosovë dhe Aeroporti i Prishtinës konfirmojnë se operimi për në/nga Beogradi/Prishtina dhe anasjelltas do të funksionojë pa taksa shtesë dhe taksa për një shërbim në linjën BPSAR. Në çfarëdo rasti, taksat dhe pagesat shtesë nuk do të jenë diskriminuese.** Kompania “Eurowings” dhe transportuesit e Grupit Lufthansa do të kenë autoritet të plotë për të shitur bileta, për t’i përcaktuar tarifat për udhëtarë, mallra dhe dërgesa postare vetëm për shërbimet e ndërsjella mes Prishtinës dhe Beogradit dhe anasjelltas.

Realizimi i shitjeve të biletave mes kompanive të një transportuesi të Grupit Lufthansa për shërbimin e ndërsjellë do të mundësohet në çfarëdo kohe, me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kushtet e rregulluesit. Autoriteti i Aviacionit Civil në Kosovë e ka të qartë se kompania “Eurowings” apo një transportues i Grupit Lufthansa e ka të drejtën për t’i përdorur shërbimet nga partnerët për kryerjen e shërbimeve të ndërsjella, me pëlqimin paraprak të autoriteteve në fjalë.

Autoriteti i Aviacionit Civil në Kosovë dhe KFOR-i do të bëhen pjesë e një plani të përshtatshëm për qeverisjen dhe zbatimin e linjës BPSAR. Në çfarëdo rasti, KFOR-i do të vazhdojë ta ketë autoritetin në hapësirën ajrore mbi Kosovë, në bazë të marrëveshjeve të njohura nga komuniteti ndërkombëtar për misionin e NATO-s në Kosovë. Në pajtueshmëri me Marrëveshjen dhe Planin, Autoriteti i Aviacionit Civil në Kosovë dhe KFOR-i do t’i harmonizojnë dhe do t’i nënshkruajnë Procedurat e Koordinimit për ekzekutimin e fluturimeve të linjës BPSAR. Në çfarëdo kohe, Autoriteti i Aviacionit Civil në Kosovë, Aeroporti i Prishtinës dhe KFOR-i do të sigurojnë realizim të sigurt të fluturimeve të linjës BPSAR, përfshirë aterimet.

Nënshkruesit: Grupi Lufthansa dhe kompania “Eurowings”, Autoriteti i Aviacionit Civil, Aeroporti i Prishtinës, Komandanti i KFOR-it